



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1094/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesmarjen e Zyrtares së Lartë Ligore Antigona Murati, duke vendlodur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 21.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.1094/2017 e datës 19.10.2017, kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2,500.00 (dymijëepesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

PZAP-i më datë 19.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS) në të cilën ka theksuar se kryetari i subjektit politik Aleanca Kosova e Re, në ditën e zgjedhjeve më 19.11.2017 ka shpërndarë një status në rrjetin e tij social Facebook, me të cilin bënë thirrje për të votuar numrin 10 të Vetëvendosjes. Më tej ka theksuar se ky veprim është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, subjekti politik LVV thekson se pretendimet e BIRN janë të pa baza për arsy se LVV ka lidhur koalicion në nivel lokal për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Prishtinës me subjektin politik AKR, andaj LVV konsideron se marrëveshjet politike ndërmjet subjekteve politike, konkretisht ndërmjet LVV dhe AKR, nuk ka asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilës do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik LVV, për shkak të publikimit të një foto me një shkrim të caktuar nga anëtarë i subjektit politik AKR pa autorizimin e subjektit politik LVV. Më tej thekson se legjislacioni në fuqi nuk i njeh koalicionet politike mbi të cilën do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit tjetër politik. Më tej ka kërkuar që ankesa e ankuesit të Refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se Kryetari i subjektit politik Aleanca Kosova e Re, Selim Pacolli, në profilin e tij në facebook, ka shpërndarë një postim në të cilin shihet se ka përbajtje të fushatës zgjedhore në diten e heshtjes zgjedhore konkretisht me datë 19.11.2017 rrëth ores 12:12 minuta, veprim ky që është në kundërshtim dhe me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton se: “*Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre*”.

Sa i përket pretendimeve të subjektit politik LVV se marrveshjet politike ndërmjet subjekteve politike, konkretisht ndërmjet LVV-së dhe AKR-së nuk ka asnjë efekt juridik mbi mbi bazën e të cilës do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik LVV, për shkak të publikimit të një foto dhe legjislacioni në fuqi nuk i njeh kolacionet politike mbi të cilën mund ti shqiptohet gjobë subjektit tjeter politik, mirëpo këto pretendime paneli i vlerësoi se nuk qëndrojnë sepse dispozita ligjore e nenit 32.5 përcakton subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre. Me këtë rast Paneli konstaton se është fakt notor i publikuar permes mediave se subjekti politik AKR mbështet kandidatin e subjektit politik Vetvendosje për kryeter të Komunës së Prishtinës, dhe Selim Pacolli në cilësin e përkrahësit dhe mbështetësit të kandidatit të LVV-së për kryetar të komunës së Prishtinës gjatë kohëzgjatjes së heshtjes zgjedhore ka bërë fushatë për kandidatin për Kryetar Komune nga radhët e subjektit politik LVV me të cilën i bëhet thirrje votuesve të votojnë numrin 10, andaj në këtë bazë rrjedh edhe përgjegjësia e subjektit politik të LVV-së.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së LVV-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjtë është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondevë që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara dhe e njëjta nuk ka ofruar prova sipas nenit 32.6 të LZP-së.

Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje është përgjegjëse për veprimet e saja pasi që ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1094/2017 më datën 21.11.2017



**Kryesues i Panelit**

Hasan Shala

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*